



Udhëzues përdorimi

Për pajtimtarët me parapagesë
Vodafone Card dhe Vodafone Club

Përmbajtja

Ju urojmë mirëseardhjen në rrjetin Vodafone	3
Udhëzime për lidhjen me rrjetin Vodafone	3
Çfarë është karta SIM, kodi i përdoruesit dhe kodet PIN / PUK, statusi i kartës SIM	4
Shërbime që mundësohen nga Vodafone	9

Ju urojmë mirëseardhjen në rrjetin Vodafone

Vodafone Albania u liçensua për herë të parë në Shqipëri më 9 Qershor 2001 si operator i dytë i shërbimit celular GSM. Liçensa e dytë e Vodafone Albania, si operatori i parë i rrjetit 3G në Shqipëri u dha më 2 Dhjetor 2010.

Kompania u zhvillua dhe vazhdon të zhvillohet me shpejtësi, me investime të mëdha, duke krijuar mundësi të pafundme për të gjithë konsumatorët e saj, shërbime të shumta që i mundëson vetëm rrjeti 3G me një mbulim shumë cilësor.

Udhëzime për lidhjen me rrjetin Vodafone

Për të lidhur numrin tuaj me rrjetin Vodafone, kryeni veprimet e mëposhtme:

- Vendosni kartën SIM në aparatit tuaj celular.
- Ndzini aparatit celular, formoni kodin PIN 1 dhe shtypni butonin # ose butonin Ok.

Kujdes!

- Ju kërkohet të lexoni me kujdes udhëzuesin për përdorimin e aparatit celular.
- Ju duhet të regjistroni numrin tuaj, në mënyrë që të lidheni me rrjetin Vodafone.
- Numri juaj mund të aktivizohet vetëm pasi të kryeni një telefonatë drejt një numri tjetër.

Kjo ishte e gjitha! Tani mund të shfrytëzoni plotësisht të gjitha mundësitë që ju jep Vodafone.

Çfarë është karta SIM, kodet PIN / PUK

Karta SIM dhe numrat personal PIN / PUK ndodhen brenda paketës së lidhjes.

PIN 1

Kodi Personal i Zhbllokimit PUK 1

Karta SIM e planit tarifer me parapagesë

Karta SIM shërben për t'ju lidhur me rrjetin Vodafone. Ajo përmban në kujtesën e saj informacione të regjistruara si dhe kodet PIN dhe PUK që ju mundësojnë lidhjen me rrjetin Vodafone si dhe përdorimin e shërbimeve të Vodafone.

Nëse ju humbet apo dëmtohet aparati juaj celular ose karta SIM, atëherë duhet të telefononi menjëherë Shërbimin e Kujdesit për Klientin me parapagesë të Vodafone, në numrin 140 nga një numër tjetër Vodafone. Për të çaktivizuar kartën do t'ju kërkohen të dhëna personale që vërtetojnë se numri celular ju përket juve.

Shënim:

Në rast se humbet apo dëmtohet karta SIM, ju mund ta zëvendësoni atë nëpërmjet një procedure shumë të thjeshtë pranë dyqaneve Vodafone, duke ruajtur kështu të njëjtin numër celulari. Si çdo aparat elektronik, edhe karta SIM është e ndjeshme ndaj disa kushteve. Ajo nuk duhet të lihet në vende me diell dhe temperatura të larta, as të përkulet apo të preket e të gërvishtet pjesa metalike mbi kartë.

PIN 1

Është kod me katër shifra që duhet të formoni sapo ndizni aparatin tuaj celular për t'u lidhur me rrjetin Vodafone.

Ky numër ju mbron nga përdorimi i paautorizuar i aparatit tuaj celular (si p.sh. në rast vjedhjeje, humbje e kartës SIM, etj.). Kodi PIN 1 mund të zhbllkohet në mënyrat e mëposhtme:

✓ Me anë të menisë së telefonit tuaj ose

✓ Duke formuar

**05 * PUK 1 * PIN 1 i ri * PIN 1 i ri # OK

Kodi PIN 1 sipas dëshirës mund të ndryshohet me një kod tjetër katërshifror me një nga mënyrat e mëposhtme:

✓ Me anë të menisë së telefonit tuaj ose

✓ Duke formuar

**04 * PIN 1 i vjetër * PIN 1 i ri * PIN 1 i ri # OK

PUK 1

Është kod me tetë shifra që përdoret për ndryshimin e PIN 1 ose për zhbllokimin e kartës SIM.

VINI RE!

- Po formuat 3 herë radhazi gabim kodin PIN 1, karta SIM bllokohet. Për zhbllokimin e saj duhet të përdorni kodin personal të zhbllokimit PUK 1
- Po formuat 10 herë radhazi gabim kodin PUK 1, karta SIM del jashtë përdorimit
- Po harruat kodin PIN, lidhuni me Shërbimin e Kujdesit për Klientin duke thirrur numrin 140 nga telefoni juaj.

PIN 2

Kodi PIN 2 mund të përdoret për të mundësuar lidhjen vetëm me disa numra të paracaktuar, në varësi të modelit të telefonit tuaj celular. Kodi PIN 2 mund të ndryshohet në mënyrat e mëposhtme:

✓ **Me anë të menisë së telefonit tuaj ose**

✓ **Duke formuar**

** 042 * PIN 2 i vjetër * PIN 2 i ri * PIN 2 i ri # OK

PUK 2

Kodi PUK 2 përdoret për të ndryshuar ose zhbllokuar kodin PIN 2. Po formuat gabim PUK 2 karta SIM nuk do të dëmtohet përfundimisht, por ju nuk do të keni mundësi të përdorni funksionet e kodit PIN 2.

✓ **Për të zhbllokuar PIN 2 formoni:**

** 05 * PUK 2 * PIN 2 i ri * PIN 2 i ri # OK

I. Statusi i Kartës SIM

Jetëgjatësia e numrit me parapagesë

Vlefshmëria e kartës me parapagesë

Duke filluar nga data 1 Shtator 2013, Vodafone Albania ka ndryshuar skemën e jetëgjatësisë të një numri me parapagesë. Numri iuaj Vodafone mund të kalojë në disa statuse, në varësi të rimbushjeve që ju do të kryeni si dhe të aktivitetit hyrës. Kalimi i këtyre fazave mund të passjellë edhe çaktivizimin e numrit tuaj nga rrjeti i Vodafone Albania.

I.I Statusi Aktiv

Ju jeni zyrtarisht pjesë e rrjetit Vodafone në momentin që do të kryeni një rimbushje, të aktivizoni një pakete apo të kryeni çfarë do lloj aktiviteti dales. Duke thirrur numrin 141 dhe zgjedhur opsionin 1, ju do të informoheni mbi datën e rimbushjes së fundit si dhe mbi datën e skadimit të këtij krediti. Data e skadimit të kreditit përcakton kohëzgjatjen e Statusit Aktiv, gjatë të cilit ju keni mundësi të përdorni të gjitha shërbimet që i përkasin planit tuaj tarifor.

Çdo rimbushje e rrit vlefshmërinë e kreditit tuaj në varësi të afatit të vlefshmërisë që ka vetë rimbushja dhe datës së skadimit të kreditit që përcakton mesazhi i regjistruar Vodafone kur telefononi në numrin 141 para kryesjes së rimbushjes.

Në çdo rast, afati më i gjatë i vlefshmërisë së kreditit i përcaktuar nga rimbushjet e kryera do të klasifikohet gjithashtu edhe si afati i skadimit të kreditit (afati me i gjatë është **6 muaj**), duke ju dhënë kështu mundësi të përdorni më shumë shërbimet dhe ofertat e Vodafone.

Nëse ju nuk e rimbushni numrin tuaj Vodafone deri në datën e përmendur në mesazhin e regjistruar, numri iuaj do të kalojë në Statusin Pasiv. Ju do të njoftoheni me një SMS 7 ditë përpara datës së kalimit në Statusin Pasiv, në mënyrë që të rimbushni llogarinë tuaj Vodafone dhe të qëndroni në statusin aktiv.

I.II Statusi Pasiv

Në rast se ju nuk kryeni asnjë rimbushje edhe brenda 7 ditësh nga momenti që jeni njoftuar me SMS, numri iuaj kalon automatikisht në Statusin Pasiv.

Statusi Pasiv i korrespondon një **periudhe 3 mujore** në të cilën ju mund të beni rimbushje, merrni thirrje, SMS, MMS, apo trasfertë krediti nga një numër tjetër, por nuk mund të kryeni aktivitet dalëse

apo të përdorni shërbimet e tjera Vodafone. Gjatë kohës që numri është në këtë status sa herë që do të merrni thirrje hyrëse apo SMS hyrës, statusi pasiv do të shtyhet **me 3 muaj**.

Nëse në momentin që numri juaj kalon në statusin pasiv balanca e kreditit tuaj është më e madhe se zero, krediti i mbetur nuk do të mund të përdoret duke qënë se në këtë status ju nuk mund të kryeni aktivitet dalës. Në rast se ju kryeni një rimbushje gjatë statusit pasiv apo nëse një numër tjetër do t'ju transferojë kredit, numri juaj do të kalojë në Statusin Aktiv, dhe krediti i mbetur në balancën tuaj do të mund të përdoret sërish.

I.III Ç'aktivizimi i numrit tuaj nga rrjeti Vodafone

Në rast se nuk kryeni asnjë rimbushje ose nuk merrni asnjë thirrje apo SMS gjatë Statusit Pasiv, atëherë numri juaj ç'aktivizohet nga rrjeti i Vodafone. Në këtë rast Vodafone do t'ju njoftojë me një SMS 10 ditë përpara datës së çaktivizimit të numrit tuaj, në mënyrë që të rimbushni llogarinë tuaj dhe numri juaj të kalojë në Statusin Aktiv.

Në rast se numri juaj çaktivizohet nga rrjeti i Vodafone, Formulari i Regjistrimit për Përdorim të Shërbimit Telefonik të Lëvizshëm për numrin tuaj konsiderohet automatikisht i zgjidhur. Pas ç'aktivizimit të numrit tuaj, Vodafone rezervon të drejtën për të shkëputur numrin tuaj nga rrjeti Vodafone.

Për çdo rast Vodafone do t'ju njoftojë me një SMS për statusin ku do të kaloni, si dhe mënyrën si mund të ktheheni në Statusin Aktiv, në të cilin do të mund të përdorni të gjitha ofertat dhe shërbimet e Vodafone Albania.

Shërbime që mundësohen nga Vodafone

Shërbime pa pagesë:

Shërbimi i Kujdesit për Klientin	140
Rimbushja e llogarisë dhe informacion për vlerën e mbetur të saj	141
Rimbushja e llogarisë nga një numër tjetër Vodafone	142
Menuja e ofertave dhe paketa	131
Aktivizimi i Shërbimit Vodafone Friends Club	132
Aktivizimi i Shërbimit MMS	136
Shërbimi Video Call	(Automatikisht, në varësi të llojit të aparatit celular)
Shërbimi “Vodafone Roaming”	140
Aktivizimi i Planit Tarifor “Vodafone Passport”	137
Aktivizimi i Planit Tarifor “Vodafone Data Passport”	137
Aktivizimi i Shërbimit “Vodafone Call Me”	138
Aktivizimi i Shërbimit të Internetit	140, 136
Shërbimi Vodafone 123	#123#
Kontrolli i Planit Tarifor	#123#

Shërbime me pagesë:

Shërbimi Vodafone Tune Me	0900929
Sekretaria Telefonike Personale	135
Shërbimi PractiCall	0900939
SOS Credit – Transfertë Krediti	147
Shërbimi i Mesazheve Zanore Mini Call	*069 XXXXXX

Shërbimi i Kujdesit për Klientin

Një ekip shumë i kualifikuar është i gatshëm dhe ka privilegjin t'ju shërbejë në çdo moment, 24 orë në ditë, 365 ditë në vit.

- Telefononi 140 - Pa pagesë
- E-mail në: kujdesi.klientit@vodafone.com | ecaresupport.al@vodafone.com

Rimbushja e llogarisë dhe informacion për vlerën e mbetur të saj

Pasi të pajisni me Kartën Rimbushëse të Vodafone, telefononi nga aparati juaj celular në numrin 141 dhe ndiqni udhëzimet e regjistruara për të rimbushur me kohë komunikimi llogarinë tuaj. Gjithashtu informacionin për vlerën e mbetur në llogarinë tuaj do ta merrni duke thirrur numrin 141.

Rimbushja e llogarisë nga një numër tjetër Vodafone

Për të rimbushur llogarinë tuaj nga një numër tjetër telefoni Vodafone, telefononi në numrin 142 dhe ndiqni udhëzimet.

Shënim

Ju do të informoheni mbi vlefshmërinë e kreditit tuaj kur të telefononi në numrin 141 për të rimbushur llogarinë tuaj me kohë komunikimi.

Aktivizimi i Shërbimit MMS

Nëpërmjet këtij shërbimi Vodafone ju mundëson një komunikim më të mirë, më të shpejtë e më origjinal. Multimedia Messaging (MMS) është pasuesi i mesazheve me tekst SMS, që lejon pajtimtarët të përfshijnë çdo kombinim të tekstit, imazheve, regjistrimeve audio, regjistrimeve video dhe informacioneve prezantuese në mesazhet që dërgojnë me telefonat celularë.

Shërbimi MMS është ndërtuar mbi rrjetin GPRS/ 3G dhe si rrjedhim pajtimtarit duhet të ketë një aparat celular të gjeneratës 3G ose 2G, i cili ka opsionin e shërbimit MMS. Informacion më të detajuar mbi listën e aparateve celularë që mundësojnë përdorimin e këtij shërbimi ose informacion mbi aktivizimin e shërbimit MMS mund të gjeni tek broshurat informuese përkatëse ose duke telefonuar Shërbimin e Kujdesit për Klientin në numrin 140.

Shërbimi Video Call

Ky shërbim ju jep mundësi të gjithë pajtimtarëve Vodafone të kryejnë telefonata me video, lehtësisht i përdorshëm nga të gjithë.

Mund të përdoret në të njëjtën mënyrë që veproni për të kryer një thirrje normale zanore. Për të përdorur këtë shërbim ju duhet të keni një aparat celular që të mund të lejojë aplikimin e tij, si p.sh. ky aparat duhet të jetë i pajisur me kamera ballore, që ju mund të shihni bashkëbiseduesin ndërkohë që komunikoni, të ketë opsionin e shërbimit Video Call si dhe të operojë në rrjetin 3G, e vetmja teknologji që mund të lejojë përdorimin e këtij shërbimi.

Kujdes!

Vodafone Video Call mund të përdoret vetëm në vendet ku ka mbulim të rrjetit 3G. Për më shumë informacion mbi çmimet e këtij shërbimi ju lutem referojuni listës së çmimeve të planit tarifor që ju i përkasin: Vodafone Club ose Vodafone Card.

Shërbimi i Roaming

Pajtimtarët me parapagesë kanë mundësinë të kryejnë e të marrin telefonata, shkëmbejnë mesazhe (SMS) të shkruara kudo që të ndodhen, si dhe të përdorin internetin nga celulari i tyre, në çdo vend të botës ku Vodafone Albania siguron këtë shërbim me anë të marrëveshjeve Roaming që ka me rrjetet përkatëse.

Kur ndodheni jashtë Shqipërisë, ju mund të zgjidhni manualisht rrjetin me të cilin Vodafone Albania ka marrëveshje Roaming, dhe më pas formoni numrin, që dëshironi të telefononi, mjafton të vendosni prefiksën përkatës kur kërkohet.

Për më shumë informacion lexoni broshurat informuese ose kontaktoni Shërbimin e Kujdesit për Klientin në numrin 140.

Për më shumë informacion telefononi në 140, ose vizitoni www.vodafone.al
Autostrada Tiranë-Durrës, Rr. "Pavarësia", Nr.61, Kashar, Tiranë, Shqipëri.

Tel: +355 4 2283072, 2283200, Fax: +355 4 2283334

Shërbimi i Kujdesit për Klientin: 140

e-mail: kujdesi.klientit@vodafone.com

ecaresupport.al@vodafone.com

www.vodafone.al

Nipt: K11715005L

Vodafone ofron shërbime dhe oferta të shumta për t'ju përshtatur nevojave tuaja të komunikimit!

Ky udhëzues përdorimi është i vlefshëm për planet tarifore me parapagesë Vodafone Card dhe Vodafone Club

VINI RE!

Kodi personal është i domosdoshëm për të marrë informacion mbi përdorimin e numrit tuaj celular, aktivizimin apo çaktivizimin e shërbimeve, si dhe zëvendësimin e kartës SIM në rast humbjeje apo dëmtimi.

Ju kujtojmë të ruani kodin në vend të sigurt!

Aktivizimi i shërbimit “Vodafone Call Me”

Shërbimi “Vodafone Call Me” i mundëson pajtimtarëve me parapagesë të Vodafone Albania të njoftohen për thirrjet e humbura kur:

- Telefoni celular është i mbyllur.
- Telefoni celular është jashtë zonës së mbulimit.
- Thirrjet telefonike janë transferuar në Sekretarinë Telefonike dhe pajtimtari marrës nuk ka lënë mesazh në sekretari.

Pasi pajtimtari Vodafone Albania do të rihapë celularin ose do të kalojë në zonën e mbulimit të Vodafone, atëherë menjëherë do të njoftohet me një SMS që përmban informacionin e mëposhtëm:

- Numrin e celularit të personit marrës.
- Kohën dhe datën e thirrjes së humbur.
- Thirrjet e kryera nga i njëjti numër (në rastet kur i njëjti person ka telefonuar më shumë se një herë).

Të gjithë pajtimtarët me parapagesë do të mund të aktivizojnë dhe çaktivizojnë shërbimin si dhe të ndërrojnë gjuhën e shërbimit, nga gjuha Shqipe në atë Angleze dhe anasjelltas, vetëm duke dërguar një mesazh (SMS) në numrin 138 me komandat e mëposhtme:

- Çaktivizimi i shërbimit “Vodafone Call Me” – Dërgo SMS me komandë 0 tek 138
- Aktivizimi i shërbimit “Vodafone Call Me” – Dërgo SMS me komandë 1 tek 138
- Ndryshimi i gjuhës në Anglisht – Dërgo SMS me komandë E tek 138
- Ndryshimi i gjuhës në Shqip – Dërgo SMS me komandë A tek 138

Aktivizimi i Shërbimit të Internetit

Ju mund të navigoni pa limit në faqet e preferuara të Internetit, mjafton të aktivizoni këtë shërbim duke telefonuar në 140 ose duke dërguar SMS me komandën **Internet** në 136.

Tashmë ju mund të përjetoni një eksperiencë të vërtetë Interneti. Mund të aksesoni çdo faqe Interneti, mund të kontrolloni e-mail-in si dhe të qëndroni në kontakt me miqtë tuaj. I shpejtë, i lehtë për t'u përdorur dhe shumë praktik.

Shënim

Tarifat e detajuara do t'i gjeni në listën e çmimeve të planit tarifor me pagesë që ju i përkisni: Vodafone Club ose Vodafone Card

Shërbimi Vodafone #123#

Vodafone 123 është rruga më e lehtë dhe më e shpejtë për të aksesuar dhe përdorur shërbimet e ofruara nga Vodafone.

Falë Vodafone 123, ju mjafton një kod i vetëm #123# dhe në pak sekonda ju do të dispononi informacionin apo shërbimin e kërkuar.

Rruga për të aksesuar shërbimin e kërkuar:

1. Formoni #123# dhe zgjidhni kategorinë që dëshironi.
2. Shtypni "Answer" dhe vendosni numrin që i korrespondon shërbimit të kërkuar.
3. Shtypni "OK"
4. Brenda pak sekondash, ju do të merrni informacion për kategorinë e përzgjedhur.

Informohuni më shpejt dhe më lehtë me Vodafone 123. Tashmë Vodafone ju mundëson marrjen e informacionit të plotë për planin tuaj tarifor si dhe ofertat më të fundit vetëm me një veprim të thjeshtë.

Shërbimi Vodafone 123 ofrohet për të gjithë pajtimtarët Vodafone pa pagesë. Ju do të tarifoheni vetëm nëse do të përdorni një nga shërbimet me pagesë apo nëse aktivizoni ofertat Vodafone.

Kontrolli i planit tarifor

Vodafone Albania ofron për të gjithë pajtimtarët e saj me parapagesë shërbimin e “Kontrollit të Planit Tarifor”. Ky shërbim u mundëson pajtimtarëve me parapagesë së kompanisë Vodafone, të informohen rreth planit tarifor të një numri me parapagesë duke formuar #123# ↩

1. Formoni #123# ↩
2. Shtypni “Answer”, vendosni numrin që i korrespondon kategorisë “Shërbime” dhe shtypni “OK”
3. Shtypni “Answer”, vendosni numrin që i korrespondon kategorisë “Kontroll i planit tarifor” dhe shtypni “OK”
4. Shtypni “Answer”, vendosni vetëm 10 shifrat e një numri Vodafone me parapagesë dhe shtypni “OK”

Brenda pak sekondash, ju do të informoheni për planin tarifor të numrit që kërkuat. Për më shumë informacion, ju lutemi të kontaktoni Shërbimin e Kujdesit për Klientin në 140.

Shërbimi Vodafone Tune Me

Aksesimi i Shërbimit Vodafone Tune Me bëhet duke:

- Dërguar SMS me komandat përkatëse në 50055 ose
- Telefonuar në 0900929 ose
- Hyrë në #123# ↩ ose
- Naviguar në www.tuneme.vodafone.al

Për tarifat e shërbimeve me pagesë referojuni listës së çmimeve të planit tarifor me parapagesë që ju i përkisni.

Shërbimi Vodafone Facebook Fast Menu

Keni një telefon të thjeshtë që nuk e suporton internetin? Vazhdoni të navigoni në Facebook nga një Internet Café? Tashmë zgjidhja erdhi... Hyni në *222# dhe aksesoni shpejt dhe thjeshtë menunë e plotë të llogarisë suaj në Facebook.

Ky shërbim është i aksesueshëm 24/7, nga të gjithë klientët Vodafone dhe nga çdo tip telefoni dhe i vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së abonimit.

Ju mund të zgjidhni të kryeni abonim ditor, javor apo mujor.

Çmimet:

Abonimi ditor	40 Lekë
Abonimi javor	220 Lekë
Abonimi mujor	700 Lekë

Të gjitha çmimet e mësipërme përfshijnë TVSHShënim: Aplikohen Kushte dhe Afate për përdorimin e Facebook Fast Menu të cilat mund t'i lexoni në faqen tonë zyrtare.

Sekretaria telefonike personale

Kur jeni duke folur, jeni jashtë rrjetit, nuk përgjigjeni në celular ose telefoni juaj është i mbyllur, sekretaria juaj telefonike regjistron për ju mesazhe me zë, të cilat mund t'i dëgjoni më vonë. Regjistrimi juaj në këtë shërbim bëhet automatikisht, pa pagesë, me thirrjen e parë nga celulari juaj. Vodafone ofron Shërbimin e Sekretarisë Telefonike me një menu më të thjeshtë dhe më të shkurtër për t'u kuptuar. Për më shumë informacion për ç'aktivizimin dhe riaktivizimin e Sekretarisë Telefonike Personale, kontaktoni Shërbimin e Kujdesit për Klientin në numrin 140.

Shërbimi PractiCall

Të gjithë ju, pajtimtarët me parapagesë mund të përdorni shërbimin PractiCall duke kryer vetëm një telefonatë në numrin 0900939 dhe menjëherë do të gjeni adresën dhe numrin telefonik për:

- Restorante dhe Hotele
- Agjenci udhëtimi dhe Imobiliare
- Klinika dhe Spitale
- Dyqane dhe Shërbime në shtëpi
- Kurse dhe Shkolla
- Servise dhe konçesionarë makinash
- Kompani Sigurimi dhe Banka
- Administrata dhe institucione

Pra, gjithë informacionin që gjendet në Çelësin e Tiranës.

Shërbimi “SOS Credit”

Shërbimi “SOS Credit” ju jep mundësinë të gjithë pajtimtarëve me parapagesë Vodafone Club dhe/ose Vodafone Card që me anë të një telefonate në numrin 147 dhe duke ndjekur udhëzimet e menusë, të transferojnë kredit nga llogaria e tyre e celularit tek një pajtimtar tjetër me parapagesë Vodafone Club dhe/ose Vodafone Card.

Shërbimi i mesazheve zanore Mini Call

Vodafone është e para kompani celulare në Shqipëri që mundësoi shërbimin e mesazheve zanore. Ju mund të dërgoni mesazhe me zë duke formuar * dhe numrin e celularit të cilit dëshironi t'i dërgoni mesazhin p.sh. * 069 XXXXXXXX
Kur ju merrni një mesazh zanor mjafton të formoni: *0* (për të dëgjuar mesazhin). Më pas ndiqni udhëzimet përkatëse.

Ju kujtojmë

Listën e çmimeve të planit tarifor Vodafone Card ose Vodafone Club si dhe shërbimeve që mund të përdoren do ta gjeni pranë dyqaneve Vodafone në mbarë vendin

- Pajtimtarët me parapagesë mund të migrojnë në Vodafone Card ose Vodafone Club në çdo moment.
- Për të kthyer numrin tuaj Vodafone Club në Vodafone Card apo anasjelltas mjafton të telefononi në 133. Ju do të njoftoheni me 1 SMS sapo të bëheni pjesë e planit të ri tarifor.

Vodafone rezervon të drejtën e ndryshimit të përmbajtjes të këtij dokumenti sipas legjisllacionit në fuqi.

Rishikimi i fundit i këtij udhëzuesi, Mars 2014.

Për më shumë informacion telefononi në 140, ose vizitoni www.vodafone.al

Autostrada Tiranë-Durrës, Rr. "Pavarësia", Nr.61, Kashar, Tiranë, Shqipëri.

Tel: +355 4 2283072, 2283200, Fax: +355 4 2283334

Shërbimi i Kujdesit për Klientin: 140

e-mail: kujdesi.klientit@vodafone.com

ecaresupport.al@vodafone.com

www.vodafone.al

Nipt: K11715005L

